



Funded by
the European Union

ISP
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK



**World Health
Organization**
European Region



Vaksinimi ndaj Fruthit Pyetje, mite dhe fakte

Çfarë duhet të dini

Çfarë është vakcina FRP?

Vaksina ndaj FRP është një vaksinë që përmban viruse të fruthit, rubeolës dhe parotitit (ose shytave) që janë dobësuar në mënyrë që të mund të prodhojnë një përgjigje imune, por nuk mund të shkaktojnë vetë sëmundjet.

Kjo përgjigje imune mbron fëmijët dhe të rriturit e vaksinuar nga sëmundja në të ardhmen.

Sa efektive është vakcina ndaj fruthit?



Një dozë e vetme e vaksinës ndaj FRP është afërsisht 95% efektive kundër fruthit, 78% efektive kundër parotitit (shytave), dhe 99% efektive kundër rubeolës.

Pas një doze të dytë vaccine ndaj FRP, mbrojtja rritet në 99% kundër fruthit dhe 88% kundër parotitit (shytave).

Fëmijët që marrin dy doza vaksinë ndaj FRP konsiderohen të mbrojtur për gjithë jetën.

Mit: Vakcina ndaj Fruthit, Rubeolës dhe Parotitit shkakton autizëm

Fakt: Nuk ka të dhëna që vakcina ndaj fruthit, rubeolës dhe parotitit shkakton autizëm por përkundrazi ka një sërë faktesh dhe të dhenash që kjo vaksinë nuk shkakton autizëm.

Pretendimi i rremë për një lidhje të mundshme të bërë në vitin 1998

është hetuar tërësisht dhe është hedhur poshtë vazhdimisht.

Shumë studime kanë treguar se nuk ka asnjë lidhje midis vaksinimit ndaj fruthit dhe autizmit përfshi këtu një studim të fundit me 650,000 fëmijë daneze I cili tregoi që vaksina ndaj fruthit, rubeolës dhe shytave “nuk rrit rrezikun për të shfaqur autizëm, nuk nxit autizmin tek femijët që mund të jenë të ndjeshëm ndaj kësaj sëmundje, dhe nuk është shoqëruar me grupime te rasteve me autizëm pas vaksinimit ”

Vaksina ndaj FRP ka qenë në përdorim për 60 vjet dhe është çertifikuar si e sigurtë dhe efektive.

Mit: Vaksina kundër fruthit mund të shaktojë fruthin

Vaksina nuk shkakton fruthin.

Ndërsa vaksina është përgatitur nga një virus i gjallë, ajo dobësohet në mënyrë që të mos shkaktojë sëmundjen, por përkundrazi bën që sistemi imunitar të njohë virusin dhe të zhvillojë imunitet ndaj tij. Për shkak se sistemi imunitar aktivizohet pas vaksinimit, disa fëmijë që marrin vaksinën mund të kenë shenja të lehta si ethe ose skuqje, por nuk është sëmundja e fruthit dhe është trupi që ndërton imunitetin ndaj virusit të fruthit në mënyrë që të mos sëmuret nëse ekspozohet ndonjëherë ndaj kesaj sëmundje.

Mit: Vaksina kundër fruthit mund të shaktojë dëmtime të rënda

Fakt : Shumica e fëmijëve nuk zhvillojnë asnjë efekt të padëshiruar anësor nga vaksina ndaj FRP. Efektet e padëshiruara anësore që mund të ndodhin janë zakonisht të lehta dhe mund të përfshijnë dhimbje, skuqje, ose ënjtje të lehtë në vendin e injeksionit. Temperatura që zgjat 2-3 ditë, simptoma të lehta të ngjashme me gripin dhe një skuqje e lehtë mund të shfaqet shtatë deri në 10 ditë pas vaksinimit, por nuk përbëjnë arsye për shqetësim.

Nuk ka pasur dëmtime apo vdekje të lidhura me vaksinën në njerëz të shëndetshëm. Vaksina nuk rekomandohet tek persona me dëmtime të rënda të imunitetit. Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme që të gjithë ata që mund të vaksinohen ta bëjnë vaskinen, për të mbrojtur ata që nuk mundet të vaksinohen . Vaksinat i nënshtrohen një procesi kërkimor shkencor dhe rigoroz përpara se të miratohen. Marrja e vaksinës është shumë më e sigurt

Kur duhet ta vaksinohet fëmija tim kundër fruthit?

Bisedoni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor për të zbuluar se kur fëmija juaj është gati për vaksinën, sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit.

Doza e parë: Doza e parë e vaksinës duhet të administrohet në moshën 12 muajshe.

Doza e dytë: Doza e dytë e vaksinës duhet të administrohet në moshën 5 vjeçare.

Nëse fëmija juaj ka humbur ndonjë dozë të planifikuar, ai mund të vaksinohet përsëri pranë qendrës shëndetësore.

A duhet të pres derisa fëmija im të flasë përpara se të vaksinohet kundër fruthit?

Jo. Vaksinimi në kohë është i rëndësishëm për t'u siguruar që fëmija juaj është i mbrojtur nga fruthi dhe sëmundje të tjera potencialisht serioze apo edhe fatale.

Vaksinimi nuk ndikon në zhvillimin e fëmijës perkundrazi ai ndhmon zhvillimin e fëmijës.

Sa serioz është fruthi?

Fruthi mund të shkaktojë sëmundje shumë të rënda.

1 në 5 fëmijë të infektuar me virusin e fruthit mund të zhvillojnë komplikime të rënda, si infeksion në vesh, pneumoni, humbje dëgjimi të përhershëm, verbëri, edemë të trurit, të cilat mund të shkaktojnë dëmtim të trurit, madje edhe vdekje.

Disa nga simptomat më të zakonshme të fruthit përfshijnë temperaturë të lartë, diarre, infeksion të veshit, kollë, rrufë, sy të skuqur të përlotur dhe skuqje.

Infeksioni nga fruthi ka treguar gjithashtu se dobëson sistemin imunitar të një personi, duke e bërë më të vështirë për të luftën kundër sëmundjeve të tjera për muaj deri në vite.

Komplikimet serioze janë më të zakonshme tek fëmijët nën 5 vjeç dhe të rriturit mbi 30 vjeç ku fruthi mund të shkaktojë një dëmtim të rëndë të trurit.

Sa ngjitës është fruthi?

Fruthi është një nga sëmundjet më ngjitëse në botë. 9 nga 10 persona pa imunitet që bien në kontakt me një person të infektuar do të infektohen dhe do të zhvillojnë sëmundjen. Një person i infektuar mund të përhapë virusin edhe para se të ketë simptoma.

Fruthi zakonisht përhapet përmes kontaktit të drejtpërdrejtë dhe përmes ajrit. Ai mund të jetojë deri në 2 orë në një sipërfaqe ose në ajër.

A është imuniteti natyror më i mirë se imuniteti i shkaktuar nga vaksina?

Jo. Vaksinimi mbron një fëmijë nga vuajtja e pasojave të sëmundjes.

Ndërsa një person në përgjithësi nuk do të infektohet përsëri pas shërimit nga fruthi, infeksioni natyror me virusin e fruthit vjen me rreziqe serioze. Një fëmijë me fruth mund të sëmuret rëndë dhe mund të zhvillojë komplikacione të rënda dhe kërcënuese për jetën deri në humbje të saj.

Vaksina ndaj FRP është një mënyrë e sigurtë dhe efektive për të mbrojtur fëmijën tuaj nga rreziku i fruthit .



Mit: Vaksina nuk te mbron si duhet ndaj fruthit dhe formave të rënda të tij apo vdekjeve. Fruthi është zhdukur vetë dhe sot shfaqet vetëm në forma të lehta

Fakt: Vaksina e fruthit parandalon mijëra vdekje çdo vit në mbarë botën. Numri i vdekjeve nga fruthi filloi të zvogëlohej përpara se të futej vaksina, falë përparimeve në kujdesin shëndetësor dhe përdorimit të antibiotikëve që përmirësoi trajtimin.

Por rastet me fruth, sëmundja e rëndë dhe vdekja nga fruthi ndodhnin ende rregullisht.. Me futjen e vaksinës , vdekjet e lidhura me fruthin në Shqipëri u zhdukën apo ishin mjaft të rralla dhe te lidhura me shperthim epidemik sepse vaksina parandalon infektimin dhe për pasojë sëmundjen dhe format e rënda të saj.

Në mbarë botën, pati një rënie prej 84 % të vdekjeve nga fruthi midis 2000 dhe 2016 pasi vaksina u bë më e disponueshme – që do të thotë se më shumë se 20 milionë vdekje u parandaluan.

Përveç vdekjes, fruthi shkakton sëmundje të rënda dhe çon në shtrimin në spital për 1 në 4 perona që sëmuren. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të shikohet reduktimi i sëmundjes së fruthit në përgjithësi.

A mund ta merrni fruthin edhe nëse jeni vaksinuar?

Ka shumë pak gjasa që pas vaksinimit të zhvillohet fruthi, dhe në ato pak raste, simptomat janë përgjithësisht më të lehta.

Rreth 99% e njerëzve që marrin 2 doza të vaksinës do të mbrohen për

MIT; Fruthi mund të parandalohet me ushqime të shëndetshme dhe higjenë të mirë

Fakt: Ndërsa higjiena e mirë ka ulur shkallën e përhapjes së sëmundjeve përmes ushqimit ose ujit për disa sëmundje si psh tifo apo kolere, ai ka një efekt minimal në fruthin, i cili përhapet nga personi në person dhe përmes ajrit. Po ashtu ushqimet e shëndetshme ndikojnë në zhvillimin e fëmijës dhe mirëqënien e personave por ato nuk parandalojnë fruthin .

Mit: Përse duhet ta vaksinojë fëmijën kur nuk ka fruth apo epidemi të tij

Në vitin 2018, pati numrin më të madh të rasteve të fruthit të raportuara që nga eliminimi i sëmundjes në vend nga viti 2005. Një shpërthim përkufizohet si tre ose më shumë raste në një komunitet dhe ka pasur shpërthime të shumta në Europë dhe në botë.

Përhapja do të ishte shumë më e madhe nëse shumica e personave në vend nuk do të vishin vaksinuar.

Sigurimi i niveleve të vaksinimit mbi 90 -95% ul mundësinë e përhapjes së fruthit tek ata që nuk janë vaksinuar. Ky quhet imuniteti i popullatës dhe është i rëndësishëm. Ai siguron mbrojtje për njerëzit që nuk mund ta marrin vaksinën, të tilla si foshnjat preparu moshes 12 muaj dhe personat me një sistem imunitar të dobësuar, për shembull nëse kanë HIV/AIDS ose kancer. Kur nivelet e vaksinimit janë më të ulëta se sa nevojiten për imunitetin e popullatës vërehen shpërthime epidemike nëse fruthi prezantohet në komunitet. Kjo është arsyeja që vërejmë më tepër fruth në ato qytete ku niveli i vaksinimit është i ulët. Dhe duke patur parasysh se fruthi është shumë ngjitës ku 9 nga 10 persona që nuk janë imunë dhe janë të ekspozuar do ta marrin atë, duke e bërë atë shumë më ngjitës se gripi do të kemi përhapje të tij tek të gjithë të pavaksinuarit nëse nuk vaksinohen në këtë moment.

**Ju keni fuqinë për të mbrojtur
fëmijën tuaj kundër **fruthit** me
një vaksinë të sigurtë dhe efektive.
Mos hezitoni. Vaksinoni**

**Për informacion të mëtejshëm kontaktoni me
mjekun ose ofruesin tuaj lokal të kujdesit
shëndetësor.**

Kjo broshurë është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e Zyrës Rajonale të OBSH-së për Evropën dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.